

Ngrini zërin

Nëse keni ndonjë shqetësim ose dyshim se ka ndodhur një shkelje e ligjit, e Kodit tonë të Sjelljes ose Kodit të Furnitorëve, ne duam që ju të ngrini zërin.

Ne synojmë të inkurajojmë singëritetin dhe do të mbështesim ata që ngrënë shqetësime, edhe nëse ato rezultojnë të gabuara. Por, një shqetësim që ngrihet me qëllim të keq, mund të sjellë masa disiplinore.

Kodi ynë i Sjelljes dhe Kodi i Furnitorëve janë të disponueshëm në intranet dhe në: www.imperialbrandsplc.com. Pyetjet mund t'i dërgoni me email në adresën Governance.Team@impbrands.com

Ka një numër mënyrash se si mund të ngrini zërin:

1. Ngrini zërin në nivel lokal

Nëse ndiheni komod, duhet t'i ngrini shqetësimet tuaja me menaxherin tuaj të personelit ose me ekipin lokal të burimeve njerëzore.

2. Ngrini zërin në nivel Grupi

Nëse nuk ndiheni komod që të ngrini shqetësimet tuaja me një koleg lokal, ose nëse keni ngritur shqetësimet tuaja në nivel lokal dhe besoni se përgjigjja lokale është e pamjaftueshme, atëherë mund të kontaktoni me dikë në Grup, ku përfshirë sa më poshtë:

- Sekretarin e Grupit të Kompanisë;
- Kontrolluesin Financiar të Grupit; ose
- Drejtorin e Burimeve Njerëzore të Grupit.

Telefon: +44 (0)117 963 6636 dhe thoni se është një çështje denoncimi.

Është e pranueshme edhe nëse preferoni që shqetësimet tuaja t'i paraqisni me shkrim. Do të na ndihmonte nëse mund të na thoni se si mund t'ju kontaktojmë për t'ju përgjigjur. Shqetësimet tuaja mund t'i dërgoni me postë ose email në adresën:

| | |
|--|---|
| The Group Company Secretary, 121 Winterstoke Road, Bristol, BS3 2LL, Mbretëria e Bashkuar E shënuar si: “Personal” | Email: speakup@impbrands.com . |
|--|---|

3. Ngrini zërin duke përdorur linjën direkte të jashtme Expolink

Ju mund të zgjidhni gjithashtu që në çdo fazë t'i ngrini shqetësimet tuaja duke përdorur shërbimin krejtësisht të pavarur të ofruar nga **Expolink**, i cili mund të kontaktohet me telefon, email, internet ose përmes aplikacionit SpeakingUp. Nëse preferoni, kjo mund të bëhet në mënyrë krejtësisht anonime. Expolink do të sigurohet që shqetësimet tuaja t'u kalohen me shpejtësi personave të duhur:

- Linja direkte Expolink operon 24 orë në ditë, 7 ditë në javë (përveç 25 dhjetorit). Numri i telefonit është i ndryshëm për çdo vend. Nëse nuk e dini numrin e duhur, shikoni tabelat lokale të njoftimeve ose vizitoni www.expolink.co.uk, www.imperialbrandsplc.com ose intranetin e Grupit
- Raportimet mund t'i dërgohen Expolink me email në adresën imperialbrands@expolink.co.uk
- Raportimet përmes internetit mund të dërgohen nga uebsajti i Expolink www.expolink.co.uk duke përdorur kodin e aksesit “imperialbrands”
- Shkarkoni aplikacionin SpeakingUp nga Apple App Store, Google Play ose

Microsoft. Përdorni kodin e aksesit "imperialbrands".

Garancia jonë për ju

Ne do ta ruajmë anonimitetin dhe konfidencialitetin e shqetësimeve tuaja sa më shumë që të jetë e mundur. Megjithatë, për të kryer një investigim të përshtatshëm, mund të jetë nevoja të zbulohen disa informacione.

Ju mund të zgjidhni që ta ngrini shqetësimin tuaj në mënyrë anonime, me kusht që kjo të lejohet nga ligjet e vendit ku ju punoni.

Ne nuk tolerojmë hakmarrjen kundër një personi që ngre zërin ose ndihmon me një hetim.

Gusht 2019